

V E N D I M
Nr.91, datë 25.2.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË "MARRËVESHJEN E KREDISË PËR ZHVILLIMIN RURAL
TË ZONËS VERILINDORE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË (IFAD)"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në "Marrëveshjen e kredisë për zhvillimin rural të zonës verilindore, ndërmjet Republikës të Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD)".

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.624, datë 13.12.1993 të bëhen këto ndryshime:

-Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Njësia e koordinimit të projektit do të ketë rregulloren e veprimtarisë së vet, që do të miratohet nga Komiteti i Koordinimit të Projektit.”

-Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“Komiteti i Koordinimit të Projektit përbëhet nga:

- Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimikryetar
- Zëvendësministri i Pushtetit Lokalanëtar
- Drejtori i Drejtorisë Ekonomike në MBUanëtar
- Drejtori i Drejtorisë së Veterinarisë në MBUanëtar
- Përfaqësuesi i aparatit të Këshillit të Ministraveanëtar
- Përfaqësusi i Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe tregtisëanëtar
- Përfaqësuesi i Ministrisë së Financaveanëtar
- Përfaqësuesi i Fondit të Zhvillimit Shqiptaranëtar
- Përfaqësuesi i institucionit të dhënies së kredisëanëtar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko